



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 52/2023 (JR)  
Nr. 52/2 regj.

Tiranë më 10.07.2024

SHPALLJE

E

NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pikat 1 dhe 3, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet e procesit, si dhe të gjithë personat e interesuar, se **ditën e hënë, datë 16.09.2024, ora 10:00**, do të shqyrtohet në seancë publike çështja me nr. regjistri (JR) 52/2023, datë 07.11.2023, që i përket ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 693, datë 10.08.2023, për subjektin e rivlerësimit **Saimir Hysa**.

Seanca publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykes përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese e Trupit Gjykes	Rezarta Schuetz
Relatore e Çështjes	Ina Rama
Gjyqtare	Albana Shtylla
Gjyqtare	Mimoza Tasi
Gjyqtar	Sokol Çomo

Bazuar në nenin 460 pika 5 e Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës së gjyqimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në faqen e internetit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në të dhënat e kontaktit të subjektit të rivlerësimit të deklaruara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, si dhe të dhënat elektronike të Institucionit të Komisionerëve Publikë.

KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES

GJYOTARE

  
REZARTA SCHUETZ

